



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 05.07.2018

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË SPANJËS, PËR ZBATIMIN E
MARRËVESHJES, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KOMUNITETIT EVROPIAN, PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME
QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR”**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 05.07.2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e Protokollit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për zbatimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Jurgis Çyrbja.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Brendshme.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji ka si qëllim lehtësimin e zbatimit të marrëveshjes, ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar, (nënshkruar më 14 prill 2005 dhe hyrë në fuqi më 1 maj 2006).

Lufta kundër migrimit të paligjshëm dhe masat për parandalimin e tij përbëjnë një nga sfidat aktuale për vendet e BE-së dhe për vendet e rajonit. Kjo sfidë, konsolidimi dhe zgjerimi i Bashkimit Evropian, si dhe angazhimet e Shqipërisë në kuadrin e procesit të stabilizim-asociimit e bëjnë të nevojshëm hartimin dhe nënshkrimin e një instrumenti ligjor, i cili ka për qëllim të forcojë frymën e partneritetit dhe të vendosë raporte të ndërsjella kontraktore detyruese ndërmjet një vendi anëtar të Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë për krijimin mbi bazë reciprociteti të procedurave të shpejta dhe efektive për identifikimin dhe ripranimin e personave, të cilët nuk plotësojnë ose nuk plotësojnë më tej kushtet për hyrjen, qëndrimin ose banimin në territorin e Republikës së Shqipërisë ose të njërës nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe të lehtësojë kthimin transit të këtyre personave në një frymë bashkëpunimi.

Iniciativa për ratifikimin e këtij protokolli bazohet në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, kapitulli 24: “Drejhtësia, Liria dhe Siguria.”

Protokolli përcakton modalitetet e aplikimit për ripranim dhe të kthimit të përgjigjes për kërkesat për ripranim.

Në tekstin e protokollit të nënshkruar ndërmjet palëve janë parashikuar mjetet dhe dokumentet shtesë, nëse autoriteti kompetent i palës kërkuese konsideron se dokumente të tjera që nuk janë të renditura në shtojcat e marrëveshjes janë të rëndësishme për të përcaktuar shtetësinë e personit që pritet të ripranohet apo për të përcaktuar arsyet për ripranimin e shtetasve nga vende të treta apo pa shtetësi.

Njëkohësisht protokollin përcakton edhe autoritetet dhe modalitetet e kryerjes së intervistës të shtetasve, nëse nuk mund të paraqitet asnjë nga dokumentet e parashikuara në shtojcat e saj.

Protokolli në nenin 7, përcakton dokumentacionin e nevojshëm për udhëtim kur jepet pëlqimi për ripranim. Një nga çështjet e rregulluara në marrëveshje është edhe mënyra e njoftimit për transferimin, pasi është dhënë pëlqimi për ripranim. Njoftimi parashikohet të përmbajë të dhëna për datën dhe të dhënat e fluturimit për transferimin, si dhe mbi përdorimin e eskortës, në rast se do të përdoret.

Neni 9 i protokollit, trajton modalitetet e aplikimit për kalimin transit. Nëse ripranimi ose transiti kryhet me eskortë, oficerët e eskortës duhet të kryejnë detyrat e tyre të paarmatosur, të jenë të veshur civilë dhe të kenë me vete pasaportë të vlefshme dhe dokumente që konfirmojnë kushtet e ripranimit apo transisit, referuar parashikimeve të nenit 10 të protokollit.

Protokolli i nënshkruar ndërmjet palëve, përcakton se në operacionet e kthimit, që ndërmerren nga pala kërkuese, për transferimet ose tranzitet që kryhen në zbatim të marrëveshjes, duhet të lejohen organet kombëtare dhe ndërkombëtare monitoruese të vëzhgojnë fazën e operacionit që kryhet në territorin e palës së kërkuar, duke përfshirë edhe dorëzimin e mundshëm të të kthyerve tek autoritetet e tyre, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Shpenzimet që rrjedhin nga ky protokoll, të parashikuara në nenin 12 të tij, merren përsipër nga pala kërkuese dhe do të mbulohen nga buxheti i parashikuar për këtë qëllim për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Autoritetet kompetente për zbatimin e këtij protokoll janë:

1. Për Republikën e Shqipërisë: – Ministria e Brendshme; – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; – Departamenti për Kufirin dhe Migracionin; – Drejtoria e Migracionit.
2. Për Mbretërinë e Spanjës: – Ministria e Brendshme; – Drejtoria Kombëtare e Përgjithshme e Policisë; – Komisariati i Përgjithshëm për të Huajt dhe Kufijtë.

Marrëveshja parashikohet të hyjë në fuqi, pas përfundimit të procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi.

III. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORI

KRYETARI

JURGIS ÇYRBJA

ULSI MANJA